
KUSHTET DHE AFATET

1. ABONIMI

1.1 Shërbimi “Teste” është një Shërbim argëtimi interaktiv ku mund të abonohen klientët e TELEKOM. Ky shërbim përbëhet nga teste të ndryshëm. Për t’u regjistruar në një nga këto shërbime, çdo abonent duhet të dërgojë një SMS me një fjalëkyç specifik, “PO” ose “OK”, ose çdo fjalëkyç tjetër të njoftuar në faqen e internetit të Shërbimit .

1.2 Duke u abonuar në Shërbim, klienti TELEKOM ka të drejtën t’i përgjigjet 1 testi/përmbajtje të ndryshme çdo ditë sipas kategorisë së shërbimit (Testi i Personalitetit, Testi i Mirëqënies, Movie Mania, Lojra me Pyetsor). Çdo test përbëhet nga 5 pyetje. Në fund të çdo testi, klienti Telekom merr një rezultat përmbledhës apo përgjigjet e pyetsorit bazuar në përgjigjet që ai(ajo) ka dhënë gjatë testit.

1.3 Për 7 ditët e para të shërbimit (për të gjithë abonentët që marrin pjesë për herë të parë), shërbimi do të jetë falas. Duke filluar nga dita e 8^{të} e në vazhdim klientët Telekom që janë regjistruar me sukses në shërbim dhe nuk janë çregjistruar nga shërbimi përkatës, do të tarifohen 19 Lekë përfshirë taksat., Abonimi do të rinovohet në bazë ditore, me përjashtim të rastit kur klienti Telekom çregjistrohet me dëshirën e tij.

1.4 Çdo klient Telekom gëzon të drejtën e një Periudhe Testimi Falas për çdo shërbim/test specifik (që do të thotë testi i Personaliteti apo teste të tjera) vetëm një herë, që nënkupton se:

1.4.1 Nëse një Klienti Telekom çregjistrohet nga shërbimi pas përfundimit të periudhës së testimit dhe pastaj regjistrohet sërish në të njëjtin shërbim, ai nuk do të gëzojë të drejtën e një periudhe shtesë Testimi Falas.

1.4.2 Nëse një Klienti Telekom çregjistrohet nga shërbimi gjatë periudhës së testimit falas dhe regjistrohet përsëri në të njëjtin shërbim, ai/ajo do të vazhdojë të përdorë ditët e mbetura të periudhës së testimit falas për të cilat gëzonte të drejtën përpara largimit nga shërbimi.

1.5 Abonentët që rregjistrohen në një Shërbim do të konsiderohen pjesmarrës deri në momentin kur do të anulojnë abonimin e tyre.

2. E DREJTA E PJESËMARRJES

2.1 Pjesëmarrja në këtë Shërbim, është ekskluzive për klientët TELEKOM (me parapagesë), mbi moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç, rezident dhe banim të përhershëm në Shqipëri dhe që rezultojnë aktualisht pa detyrime financiare ndaj Organizatorit, duke përfshirë të gjithë punonjësit, përfaqësuesit, agjentët dhe agjencitë e TELEKOM, të afërmit e shkallës së parë dhe/ose kompanitë filialet, kontraktorët apo partnerët, dhe ata me të cilët banojnë personat e lartpërmendur. Personi që zotëron Numrin Ndërkombëtar të Stacionit Celular të Numeratorit të Abonentit (në vijim referuar si “MSISDN”) ose ka

një autorizim të shprehur nga zotëruesi i MSISDN, për ta përdorur atë, do të konsiderohet si Klient Telekom, pavarësisht përdoruesit aktual të telefonit.

3. TERRITORI

3.1 Shërbimi do të jetë i disponueshëm në të gjithë territorin kombëtar të Shqipërisë.

4. SHËRBIMI “TESTE”

4.1 Shërbimi “Teste” ka për synim që Klientët Telekom të përdorin testet dhe pyetsorët e Organizatorit (“Teste”), me tematika lidhur me subjekte të ndryshme. Gjatë rrjedhës së Shërbimit do të lançohen 4 (katër) shërbime pyetsorësh, 1 (një) në çdo tremujor. Në rast të cdo ndryshimi, Klienti Telekomit do të informohen në faqen e Telekomit www.telekom.com.al/lojra

TESTET/KATEGORITE
1. Testi i Personalitetit
2. Testi i Mirëqënies
3. Movie Mania
4. Lojra me Pyetsor

4.2 Pas lançimit, çdo shërbim do të jetë i disponueshëm deri në fund të kohëzgjatjes së Shërbimit “Teste”

4.3 Klientët e interesuar në përdorimin e një prej shërbimeve, duhet të të dërgojnë një SMS tekst, i cili është pa pagesë, si në vijim:

4.3.1 Klientët Telekom të interesuar në përdorimin e shërbimit (1) Testi i Personalitetit, duhet të dërgojnë falas një SMS tek numri i shkurtër 55577 me fjalët kyç “PO”, “OK” apo çdo fjalëkyç tjetër që njoftohet gjatë fushatës së reklamimit. Klienti Telekom do të gëzojë një periudhë testimi falas 7 ditore të përmbajtjes e cila fillon në ditën që Klienti Telekom regjistrohet duke dërguar mesazhin e parë me fjalëkyçin e shërbimit (të specifikuar nga Organizatori) dhe me marrjen e mesazheve mikpritëse që konfirmojnë se ata janë abonuar në Shërbim. Të gjithë Klientët Telekom gëzojnë të drejtën e 7 Testeve falas të Personalitetit pavarësisht ditës në të cilën ata abonohen në Shërbim. Pas periudhës falas, Klienti do të tarifohen me 19 Lekë/ditë, duke përfshirë të gjitha taksat e zbatueshme.

4.3.2 Klientët Telekom të interesuar në përdorimin e shërbimit (2) Testi i Mirëqënies, duhet të dërgojnë falas një SMS tek numri i shkurtër që do të njoftohet në faqen e Telekom me fjalët kyç “PO”, “OK” apo

çdo fjalëkyç tjetër që njoftohet gjatë fushatës së reklamimit. Klienti Telekom do të gëzojë një periudhë testimi falas për 7 ditët e para, e cila fillon në ditën që Klienti Telekom rregjistrohet duke dërguar mesazhin e parë me fjalëkyçin e shërbimit (të specifikuar nga Organizatori) dhe me marrjen e mesazheve mikpritëse që konfirmojnë se ata janë abonuar në Shërbim. Të gjithë Klientët Telekom gëzojnë të drejtën e 7 Testeve falas të Mirëqënies pavarësisht ditës në të cilën ata abonohen në Shërbim. Pas periudhës së testimit falas, klienti Telekom do të tarifohet me 19 Lekë/ ditë, duke përfshirë të gjitha taksat.

4.3.3 Klientët Telekom të interesuar në përdorimin e shërbimit (3) Testi i Kinemasë, duhet të dërgojnë falas një SMS tek numri i shkurtër që do të njoftohet në faqen e Telekom me fjalët kyç, “PO”, “OK” apo çdo fjalëkyç tjetër që njoftohet gjatë fushatës së reklamimit. Klienti Telekom do të gëzojë një periudhë testimi falas për 7 ditët e para, e cila fillon në ditën që Klienti Telekom rregjistrohet duke dërguar mesazhin e parë me fjalëkyçin e shërbimit (të specifikuar nga Organizatori) dhe me marrjen e mesazheve mikpritëse që konfirmojnë se ata janë abonuar në Shërbim. Të gjithë Klientët Telekom gëzojnë të drejtën e 7 Testeve falas të Kinemasë pavarësisht ditës në të cilën ata abonohen në Shërbim. Pas periudhës së testimit falas, klienti Telekom do të tarifohet me 19 Lekë/ ditë, duke përfshirë të gjitha taksat.

4.3.4 Klientët Telekom të interesuar në përdorimin e shërbimit (4)Loja me Pyetësor, duhet të dërgojnë falas një SMS tek numri i shkurtër që do të njoftohet në faqen e Telekom me fjalët kyç, “PO”, “OK” apo çdo fjalëkyç tjetër që njoftohet gjatë fushatës së reklamimit. Klienti Telekom do të gëzojë një periudhë testimi falas për 7 ditët e para, e cila fillon në ditën që Klienti Telekom rregjistrohet duke dërguar mesazhin e parë me fjalëkyçin e shërbimit (të specifikuar nga Organizatori) dhe me marrjen e mesazheve mikpritëse që konfirmojnë se ata janë abonuar në Shërbim. Të gjithë Klientët Telekom gëzojnë të drejtën e 7 testeve falas të Lojës me Pyetësor, pavarësisht ditës në të cilën ata abonohen në Shërbim. Pas periudhës së testimit falas, klienti Telekom do të tarifohet me 19 Lekë/ ditë, duke përfshirë të gjitha taksat.

4.4 Pas regjistrimit të suksesshëm, klientët do të marrin nga kodi përkatës i shkurtër, SMS MTs e mëposhtme (“MT” – Mobile Terminated – Mesazh i Terminuar SMS):

- Një mesazh mikpritës që konfirmon regjistrimin me sukses të tyre
- Një mesazh që përmban informacion lidhur me Shërbimin
- Një mesazh me testin e parë të ditës

4.5 Çdo SMS përmban pyetjen dhe 3 variante përgjigjesh të gatshme. Klienti zgjedh njëri prej opsioneve që i përshtatet më shumë.

4.6 Organizatori gëzon të drejtën të anulojë ose ndryshojë Përmbajtjen e Shërbimit si dhe këto Kushte dhe Afate në çdo kohë. Çdo ndryshim do të publikohet online në www.telekom.com.al/lojra.

5. KOSTOJA & PJESËMARRJA

5.1 Kostoja e Shërbimit është 19 Leke (duke përfshirë të gjitha taksat) çdo ditë (“Kosto e Shërbimit Ditor”) për shërbim dhe do të tarifohet drejtëpërdrejtë për shërbimet me parapagesë. 7 ditët e para të shërbimit janë pa asnjë kosto (falas).

5.2 Nuk do të ketë asnjë kosto tjetër të përfshirë për përdorimin e Shërbimit.

5.3 Klienti Telekom nuk do të tarifohet më shumë se 19 Leke (duke përfshirë taksat) çdo ditë për Shërbimin.

5.4 Klienti Telekom mund të kërkojë ndihmë duke dërguar, pa asnjë kosto shtesë, komandën “INFO” ose çdo fjalëkyç tjetër dhënë për këtë qëllim dhe të komunikuar në mesazhet e çdo shërbimi, drejt numrit përkatës

5.5 Klienti Telekom, në çdo kohë, mund të kërkojë anulimin e pjesmarrjes së tij/saj në Shërbim thjesht duke dërguar komandën “STOP” ose çdo fjalëkyç tjetër dhënë për këtë qëllim dhe të komunikuar në mesazhet e çdo shërbimi, pa asnjë pagesë drejt numrave përkatës.

5.6 Dërgimi i kësaj komande tek një numër i vetëm nuk do të rezultojë në anulimin e abonimit për të gjitha shërbimet, por vetëm në anulimin e shërbimit dhe ofertave të komunikuar përmes atij numri të shkurtër.

5.7 Gjatë ditës do të ketë disa përpjekje për faturimin e shërbimit. Nëse nuk është e mundur të kryhet faturimi deri në fund të ditës, atëherë Klienti Telekom nuk do të marrë shërbimin për atë ditë.

5.8 Për qëllimin e të gjitha shërbimeve, testeve, Organizatori do të përdorë numrat e shkurtër për të komunikuar me bazën e Klientëve të tij.

5.9 Klientët Telekom, përmes regjistrimit të tyre në shërbim, shprehin pranimin e tyre total dhe të pakushtëzuar ndaj dispozitave të Kushteve dhe Afateve këtu.

6. LIGJI I ZBATUESHËM DHE NDRYSHIMET

6.1 Ky Shërbim Përbajtje dhe ky Promovim organizohet dhe qeveriset nga ligjet dhe statutet e Republikës së Shqipërisë.

6.2 Këto Kushte dhe Afate janë të vlefshme gjatë Periudhës së Shërbimit deri në ndryshimin apo ndërprerjen e tyre nga TELEKOM.